



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:076512

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06316853

C.nr.430/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Mevlide Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton“, nr.5, kundër të paditurit B.A. nga Gj., rr.”N. B.”, pa nr.me objekt të kontestit kompensimin e dëmit material, me vlerë të kontestit 715.93 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 17.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
(Në bazë të padëgjueshmërisë/ mosbindjes)

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë.

II. DETYROHET i padituri B. A. nga Gj., që paditëses, në emër të dëmit material të shkaktuar t’ia paguaj shumën prej 715.93 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 20.00 euro, në afat prej 7 ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë më datën 14.04.2022, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për shkak të kompensimit të dëmit material, me vlerë të kontestit në shumën prej 715.93 euro, duke theksuar se sipas aktykimit penal të Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.../18 të datës 19.10.2020, i cili ka marrë formën e prerë më datën 18.12.2020 i padituri është shpallë fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale “vjedhje e shërbimeve”, përderisa i dëmtuari, tani paditësja është udhëzuar në kontest civil. Më tutje ka shtuar se i padituri me qëllim që vetit t’i sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin e tensionit të ulët, duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe duke shpenzuar energji elektrike pa matje, me çka me këto veprime i padituri palës paditëse i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 715.93 euro.

Ashtu nga gjykata ka kërkuar që ta obligoj të paditurin B. A. nga Gj. që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguaj shumën prej 715.93 euro, duke llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi C.nr.../2023, të datës 30.05.2024, të cilin i padituri ka refuzuar ta pranoi, fakt të cilin gjykata e vërtetoi nga fletëkthesa që gjendet në shkresat e lëndës me datë 31.01.2023. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë e njëjta nëse nuk paraqet përgjigje në padi brenda afatit ligjor, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes .

I padituri, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur se në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150, par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK-së, në të cilën dispozitë shprehimisht parashihet se *“Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.”*

Gjykata nga provat që i janë bashkangjitur padisë e ka vërtetuar faktin se e paditura me aktgjykimet penale të Gjykatës Themelore në Gjiilan P.nr...../18 të datës 19.10.2020, i cili ka marrë formën e prerë më datën 18.12.2020 i padituri është shpallë fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale “vjedhje e shërbimeve”, përderisa i dëmtuari, tani paditësja është udhëzuar në kontest civil, për shkak se i padituri me me qëllim që vetit t'i sjell pasuri të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike në mënyrë të paautorizuar, ashtu që ka bërë lidhje direkte në rrjetin e tensionit të ulët, duke anashkaluar njehsorin elektrik dhe duke shpenzuar energji elektrike pa matje, me çka me këto veprime e paditura palës paditëse i ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 715.93 euro, fakte këto të vërtetuara nga aktgjykimet e lartcekura penale dhe të formës së prerë, po ashtu ky fakt vërtetohet edhe nga Transaksionet e konsumatorit DGL, me numër të njehsorit, andaj vlerësoi se paditësja ka argumentuar përgjegjësinë e të paditurës në shkaktimin e këtij dëmi përmes aktgjykimve penale të lartpërmendura dhe vlerën e dëmit të shkaktuar përmes transaksionit të konsumatorit në emër të të paditurës.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), edhe atë nenit 8 i cili përcakton “Secili person ka për detyrë të përmbahet

nga veprimi që mund t'i shkaktoj dëm tjetrit"; nenit 136, paragrafi 1 se "Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij"; nenit 137 se "Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)"; nenit 140 se "Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia"; si dhe nenit 169, paragrafi 1 se "Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi".

Meqë i padituri e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me shkresat e lëndës, ndërsa nuk ka kthyer përgjigjen në padi, ndërsa faktet e treguara në padi mbështeten në provat e theksuara si më lartë dhe kërkesa është e themeltë bazuar dispozitave ligjore të LMD-së, gjykata vendosi që të nxjerrë aktgjykim pa konvokuar shqyrtim gjyqësor, duke aprovuar kërkesën e paditësit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për shkak të plotësimin të kushteve të parapara në nenin 150 të LPK-së.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi për kamatë ligjore prej 8%, duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimre, gjykata vendosi në kuptim të nenit 452 të LPK-së, duke e aprovuar shumën prej 20 euro për taksë gjyqësore për padinë e paraqitur.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 150 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.430/2022 më datën 17.10.2024

Gjyqtarja,
Mevlide Shabani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.